

# PJESËMARRJA E GRAVE NË VENDIMMARRJE NË KOSOVË

Qendra Kosovare për Studime Gjinore



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar  
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

## **Falënderim**

“Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë” është hulumtim i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), i publikuar në kuadër të projektit “Koalicioni për të Drejta të Barabarta për të Gjithë”, financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

QKSGJ falënderon të gjithë ata që ndihmuan dhe ofruan informata dhe të dhëna për këtë raport.

**Hulumtuese kryesore:** Lavdi Zymberi

**Hulumtuese ndihmëse:** Nita Zogiani

**Redaktore:** Luljeta Demolli

## **Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) [www.kgscenter.net](http://www.kgscenter.net)**

QKSGJ ka kontribuar në përfshirjen gjinore që nga viti 2002 dhe bën përpjekje vazhdimisht për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë. Ajo ka qenë nismëtare për të ndryshuar sistemin diskriminues, normat shoqërore dhe standardet e dyfishta, dhe është shumë aktive në monitorimin e institucioneve publike. Misioni i QKSGJ-së është integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha analizat, programet dhe politikave të gjitha sektorëve të shoqërisë kosovare përmes ngritjes së vetëdijes për çështje gjinore, zhvillimit të studimeve gjinore, dhe përmes sigurimit të përfshirjes së politikave të ndjeshme nga aspekti gjinor; përmes hulumtimeve, zhvillimit të politikave, avokimit dhe lobimit.

Adresa:

Rruga Nëna Terezë Nr. 18/1,

10000 Prishtinë – Kosovë,

Tel. +381 (0) 38 735 991

## **Klauzolë e përgjegjësisë**

Ky publikim është hartuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore dhe nuk paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Raporti është hartuar si pjesë e Koalicionit të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC), një projekt katër vjeçar, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga ZBE në Kosovë. Ndër të tjera, Koalicioni mbështet Zyrën për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në organizimin e procesit kërkimor, publikimin dhe prezantimin e dokumenteve të politikave për sa i përket gjashtë (6) të drejtave themelore si në vijim: të drejtës për barazi para ligjit; të drejtës për liri dhe siguri; të drejtës së lirisë së shprehjes; të drejtës për arsimim; të drejtës për punë dhe profesion; të drejtës për shëndetësi dhe mbrojtje sociale.

## **E drejta autoriale**

© Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Janar 2017. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo lloji mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, incizimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të QKSGJ-së.



# PJESËMARRJA E GRAVE NË VENDIMMARRJE NË KOSOVË

Qendra Kosovare për Studime Gjinore



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar  
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



## **PËRMBAJTJA**

---

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	9
HYRJE.....	10
METODOLOGJIA.....	12
KORNIZA LIGJORE, HULUMTIME DHE RAPORTE TË MËPARSHME.....	13
KORNIZA LIGJORE.....	13
HULUMTIME DHE RAPORTE TË MËPARSHME.....	15
GJENDJA AKTUALE.....	17
NIVELI QENDROR.....	17
QEVERIA.....	17
SHËRBYESIT CIVIL TË KUVENDIT.....	22
PRESIDENCA.....	24
NIVELI LOKAL.....	25
PËRFUNDIME.....	29
REKOMANDIME.....	30
HAPATERADHËS.....	31
REFERENCAT.....	32

## **LISTA E TABELAVE**

---

- Tabela 1. Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin 2013
- Tabela 2. Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin 2014
- Tabela 3. Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin for 2015
- Tabela 4. Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin 2016
- Tabela 5. Pozitat e larta drejtuese sipas ministrive
- Tabela 6. Pozitat drejtuese sipas ministrive

## **LISTA E GRAFIKONEVE**

---

- Grafiku 1. Përfaqësimi gjinor në Qeveri
- Grafiku 2. Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin 2016
- Grafiku 3. Pozitat e larta drejtuese në qeveri
- Grafiku 4. Pozitat drejtuese në qeveri
- Grafiku 5. Përfaqësimi gjinor në Kuvend
- Grafiku 6. Pozitat (e larta) drejtuese në Kuvend
- Grafiku 7. Këshilltarët politik të Presidentit
- Grafiku 8. Përfaqësimi gjinor në Presidencë(shërbyesit civil)
- Grafiku 9. Pozitat (e larta) drejtuese në Presidencë
- Grafiku 10. Përfaqësimi gjinor në komuna
- Grafiku 11. Përfaqësimi i grave në secilën komunë
- Grafiku 12. Pozitat drejtuese në Komuna - drejtorët e drejtorateve komunale
- Grafiku 13. Pozitat drejtuese në komunat e Kosovës në 2013-2014
- Grafiku 14. Pozitat drejtuese në komunat e Kosovës në vitin 2015

## **LISTA E SHKURTESAVE**

---

<b>ABGJ</b>	Agjencia për Barazi Gjinore
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>LBGJ</b>	Ligji për Barazi Gjinore
<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MeD</b>	Ministria e Diasporës
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MFSK</b>	Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës
<b>MI</b>	Ministria e Infrastrukturës
<b>MIE</b>	Ministria e Integriteteve Evropiane
<b>MKK</b>	Ministria për Komunitete dhe Kthim
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MPJ</b>	Ministria e Punëve të Jashtme
<b>MPMH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>MTI</b>	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
<b>MZHE</b>	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
<b>QKSGJ</b>	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
<b>ZK</b>	Zyra e Kryeministrit





## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë konsiderohet të jetë e vogël përkundër kërkesës ligjore nga Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 6, pika 8, që thekson se “përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”.

Qëllimi i hulumtimit ishte të vlerësohet pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në nivelin qendror (Qeveri, Kuvend dhe Presidencë) dhe në nivelin lokal (komuna) në Kosovë. Kjo u zhvillua përmes një hulumtimi që u bazua në statistikat aktuale në dispozicion të mbledhura nga disa institucione dhe analizat e raporteve më të fundit për këtë çështje.

Ligji për Barazi Gjinore (LBGJ) nuk zbatohet as nga institucionet qendrore dhe as nga ato lokale në Kosovë. Përfaqësimi i grave në vitin 2016 në Qeveri si tërësi, d.m.th. ministritë dhe Zyrën e Kryeministrit është vetëm 40.6%. Në anën tjetër, komunat e Kosovës kishin vetëm 28% gra nga numri i përgjithshëm i të punësuarëve në vitin 2015. Për më tepër, pozitat drejtuese si në Qeveri edhe në komuna vazhdojnë të dominohen nga meshkujt. Vetëm 5.2% të pozitave drejtuese në Qeveri në vitin 2015 drejtoheshin nga gratë, përderisa në komuna kjo përqindje ishte 10.1% (14 komuna nuk kanë pasur asnjë grua në pozitë drejtuese). Gjithashtu, si në Presidencë ashtu edhe në Kuvend grate janë të nënpërfaqësuar: statistikat aktuale tregojnë se vetëm 14 nga 32 pozita (të larta) drejtuese udhëhiqeshin nga gratë në vitin 2015, përderisa në Kuvend grate udhëhiqnin vetëm 19 nga 52 pozita (të larta drejtuese).

Bazuar në të dhënat e mbledhura për gjendjen aktuale të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në Kosovë, Qendra Kosovare për Studime Gjinore jep rekomandimet në vijim:

- Rekomandohen institucionet shtetërore (veçanërisht ato me zbatueshmëri më të ulët si: Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Jashtme) të zbatojnë masat e veçanta nën nenin 6 të Ligjit për Barazi Gjinore për të përshpejtuar realizimin e barazisë gjinore në ato fusha ku ekzistojnë pabarazitë. Këto masa të veçanta duhet të përdoren në mënyrë sistematike kur ka vende të lira pune në institucione;
- Rekomandohet Agjencia për Barazi Gjinore të përgatisë Programin e Kosovës për Barazi Gjinore dhe të marrë parasysh prioritetet që dalin nga Plani i ri i Veprimit Gjinor i Bashkimit Evropian 2016-2020;
- Rekomandohet Ministria e Administratës Publike t’i publikojë statistikat dhe raportet e ndara sipas gjinisë për gjendjen në shërbimin civil në faqen e saj të internetit në mënyrë që të jenë të qasshme për palët e interesuara; dhe
- Rekomandohet Ministria e Administratës Publike t’i mbledh të dhënat e ndara sipas gjinisë për të emëruarit për pozitat e këshilltarëve politik të krerëve të shtetit të financuar nga buxheti i shtetit të Kosovës.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore do t’i përdorë të dhënat nga ky raport për të:

- Avokuar për përmirësimin e gjendjes aktuale sa i përket përfaqësimit të grave në vendimmarrje;
- Kryer një rast gjyqësor kundër një institucioni publik që më së shumti është duke shkelur Ligjin për Barazi Gjinore; dhe
- Avokuar tek Ministria e Administratës Publike për t’i publikuar rregullisht të dhënat e shërbyesve civil të ndara sipas gjinisë.

Rritja e pjesëmarrjes së grave në jetën publike përbën një element kyç për zhvillim dhe demokratizim të një vendi. Përfshirja e grave në të gjitha aspektet e jetës politike është e rëndësishme jo vetëm sepse gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë, por edhe sepse arritja e pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave në vendimarrjen politike dhe publike është çështje e zotërimit të plotë të të drejtave të njeriut, drejtësisë sociale dhe një kusht i nevojshëm për funksionim më të mirë të një shoqërie demokratike. Arritja e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në vendimarrjen politike dhe publike çon në vendimarrje më të mirë dhe më efikase dhe ripërkufizim të prioriteteve politike dhe vënie të çështjeve të reja në agjendën politike. Gjithashtu, kjo kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës.<sup>1</sup>

Pjesëmarrja e rritur e grave në vendimarrje i kontribuon proceseve pozitive transformuese për shoqëritë, siç janë ndryshimet e ligjeve, politikave, shërbimeve, institucioneve dhe normave shoqërore.<sup>2</sup> Është e rëndësishme të sigurohet që të dëgjohen zërat e grave për vendimet që prekin jetët e tyre, jetët e familjeve të tyre dhe komunitetit më gjërë. Këto vendime prekin gratë po aq sa edhe burrat. Prandaj, gratë duhet të përfshihen në vendimarrje në çdo fushë dhe të kenë fuqi dhe numër të barabartë me burrat.<sup>3</sup> Është përgjegjësi e qeverisë të sigurojë që grave iu ofrohen mundësi për të marrë pjesë në të gjitha nivelet e vendimarrjes dhe se institucionet përfaqësojnë një llojllojshmëri të njerëzve dhe komuniteteve që ato përfaqësojnë.

Nevoja e fuqizimit të grave dhe rritjes së pjesëmarrjes së tyre në vendimarrje është paraparë në Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në vitin 1979.<sup>4</sup> Konventa është ratifikuar nga 190 shtete anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i CEDAW është të hiqen të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe të arrihen liri të plota njerëzore dhe të drejta për gratë në kushte të barabarta me burrat. Konventa gjithashtu kërkon të eliminohet diskriminimi kundër grave në jetën publike dhe politike. Preambula e Konventës thotë, në një pjesë të saj:

"Duke rikujtuar se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në të njëjtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbimin e atdheut të tyre dhe njerëzimit."

Në vitin 1990, kërkesa për të eliminuar diskriminimin kundër grave në jetën publike dhe politike u shndërrua në rezolutë nga Këshilli Ekonomik dhe Social i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (ECOSOC)<sup>5</sup> që rekomandonte një cak prej 30% të grave në pozita vendimarrëse deri në vitin 1995, dhe 50% deri në vitin 2000. Deri në vitin 2015, asnjëri nga caqet nuk është arritur.<sup>6</sup> Për këtë arsye, Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim<sup>7</sup> synoi "baraspeshën gjinore" dhe pjesëmarrjen në numër të barabartë të burrave dhe grave në organet qeveritare, si dhe në ato të administratës

<sup>1</sup> Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandim Rec(2003)3

<sup>2</sup> Strategjia për Barazi Gjinore (2014-2017) e Këshillit të Evropës

<sup>3</sup> Kofi Anan, Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së

<sup>4</sup> UN Women (2015) Gratë në Pushtet & Vendimarrje

<sup>5</sup> Rezolutat e ECOSOC

<sup>6</sup> 11.3% në vitin 1995 dhe 22% në vitin 2015

<sup>7</sup> Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim

publike u miratu në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë. Pesë vite më vonë (në vitin 2000), duke marrë për bazë ndikimin e ndryshëm të luftës tek gratë, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1325 "Gruaja, paqja dhe siguria".<sup>8</sup> Rezoluta rithekson nevojën e fuqizimit të rolit të grave në vendimmarrje për parandalim dhe zgjidhje të konfliktit.

Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë, si në numër ashtu edhe ndikim aktual, është ballafaquar me shumë pengesa për arsye të ndryshme. Mentaliteti dhe analfabetizmi konsiderohen të jenë arsyet kryesore në kufizimin e rolit të grave në vendimmarrje. Kjo situatë filloi të ndryshojë me prezantimin e kuotës prej 30% të ulëseve në Kuvend të Kosovës dhe Kuvende Komunale që filluan të rezervohen për gratë që nga viti 2000. Pjesëmarrja e grave në jetën politike krijoi një mjedis më miqësor për përfaqësimin e tyre në nivelet tjera të vendimmarrjes, përfshirë nivelin lokal. Megjithatë kuota gjinore sfidohet, ajo ka çuar dukshëm në një shtim të deputeteve; në legjislaturën aktuale janë 39 deputete<sup>9</sup>. Gjithashtu vlen të përmendet që 20 deputete nga 39 janë zgjedhur përmes votës preferenciale, që nënkupton 5 gra më shumë krahasuar me zgjedhjet e mëparshme të përgjithshme në vitin 2010.<sup>10</sup>

Duke marrë parasysh detyrimin ligjor për të siguruar barazi gjinore në të gjitha aspektet e jetës në Kosovë, një rëndësi më e madhe duhet t'i kushtohet përfshirjes së grave në vendimmarrje. E drejta për barazi të grave dhe burrave kërkon që autoritetet lokale dhe rajonale t'i marrin të gjitha masat e duhura dhe të miratojnë strategjitë e përshtatshme për të promovuar përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në të gjitha sferat e vendimmarrjes.<sup>11</sup>

Qëllimi i këtij hulumtimi është të vlerësohet gjendja aktuale sa i përket pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje si në nivel qendror (Qeveri, Kuvend, Presidencë) edhe në atë lokal (komuna) në Kosovë dhe të ofrojë rekomandime për politika për organet përgjegjëse shtetërore. Masat në vijim janë ndërmarrë për të kuptuar më mirë situatën aktuale të grave si dhe për të pasur mundësi të jepjen rekomandime se si mund të përmirësohet barazia gjinore në vendimmarrje:

- Të analizohet dhe paraqitet pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në nivelet e ndryshme të hierarikë në institucionet qendrore (Qeveri, Kuvend dhe Presidencë)
- Të analizohet pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në institucionet lokale (komuna) dhe
- Të analizohet ndikimi i miratimit të pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut në vitin 2015 për mosdiskriminim të grave.

Raporti përfshin një pjesë për metodologjinë, e cila shpjegon metodat e përdorura për të mbledhur të dhënat. Raporti gjithashtu përfshin kornizën ligjore dhe hulumtimet e mëparshme të realizuara nga akterë të përfshirë në këtë fushë të studimit. Pjesa e raportit që trajton gjendjen aktuale ndahet në dy pjesë: niveli qendror dhe niveli lokal. Përfundimet paraqesin çështjet më kritike të gjetura nga ekipi hulumtues i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ). Rekomandimet për përmirësim bazohen në të gjeturat nga raporti dhe kornizën ligjore të zbatueshme në Kosovë, si CEDAW, Kushtetuta, dhe Ligji për Barazi Gjinore. QKSGJ-ja do të zbatojë disa hapa për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të saj.

<sup>8</sup> Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së

<sup>9</sup> Instituti Kombëtar Demokratik (IKD), Kosovë: Tejkallimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë

<sup>10</sup> Instituti Kombëtar Demokratik (IKD), Kosovë: Tejkallimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë

<sup>11</sup> Karta Evropiane për Barazi mes grave dhe burrave në jetën lokale

## **METODOLOGJIA**

---

Ekipi prej dy anëtarësh nga QKSGJ ka punuar nga muaji qershor 2016 në mbledhjen e informatave dhe për të përgatitur raportin për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në Kosovë.

Ky është një raport i hulumtimit nga zyra të burimeve kyçe në dispozicion, përfshirë kornizën ligjore, raportet dhe hulumtimet e mëparshme për temën, si dhe intervistat joformale me Ushtruesen e detyrës së Kryeshefes ekzekutive të ABGJ-së, Zyrtaren e lartë për barazi gjinore në MAPL dhe Zyrtaren e lartë për personel në MAP.

Të dhënat për institucionet shtetërore të përfshira në këtë hulumtim, dmth. numri i përgjithshëm i grave të punësuar si dhe numri i përgjithshëm i grave në pozita drejtuese u siguruan nga MAP-i.

Të dhënat për përfaqësimin e grave në nivelin lokal (komuna) u siguruan nga Zyrtarja për barazi gjinore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Këto të dhëna përfshijnë informata për numrin dhe përqindjen e anëtarëve të kuvendeve komunale, shërbyesve civil, dhe pozitave vendimmarrëse (drejtorëve të drejtorateve).

Të dhënat për numrin e këshilltarëve të Presidentit janë marrë përmes komunikimit zyrtar me Presidencën.

Të dhënat për numrin e këshilltarëve të Kryeministrit janë marrë pas parashtrimit të kërkesës zyrtare për qasje në dokumente publike.

Gjatë hulumtimit ekipi i QKSGJ-së kuptoi se ministria përgjegjëse për shërbim civil nuk ka një bazë të duhur të dhënash që do të përmbante të gjitha informatat e nevojshme në aspektin e ndarjes së të dhënave të shërbyesve civil bazuar në gjini, moshë, dhe ndarjen e të dhënave të institucioneve nga agjencitë e tyre të pavarura. Kuvendi i Kosovës nuk ia ofroi QKSGJ-së të dhënat e kërkuara për këshilltarët politik të Kryetarit të Kuvendit edhe pas parashtrimit të kërkesës zyrtare për qasje në dokumente publike.

### KORNIZA LIGJORE

Të drejtat themelore të njeriut janë të vendosura fortësisht në Kushtetutën e Kosovës. Parimi i barazisë gjinore është i rregulluar me Kushtetutën<sup>12</sup> e Republikës së Kosovës si dhe me ligjet tjera të zbatueshme. Sipas Kushtetutës<sup>13</sup> të dy gjinitë kanë të drejta të barabarta për pjesëmarrje në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe në fushat tjera.

Megjithëse Kosova nuk është nënshkruese e marrëveshjeve madhore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Kushtetuta e Kosovës thekson se të gjitha instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë të zbatueshme drejtpërdrejt.<sup>14</sup> Më saktësisht, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) mishërohet gjithashtu në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës.<sup>15</sup> Promovimi dhe fuqizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve të Kosovës rregullohet përmes legjislacionit të ndryshëm civil dhe penal përfshirë pakon e legjislacionit për të drejtat e njeriut (d.m.th. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, ligji për Avokatin e popullit dhe Ligji për barazi gjinore), që hyri në fuqi në korrik të vitit 2015. Miratimi i pakos së legjislacionit për të drejtat e njeriut u theksua si një hap i madh para në Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2015 për Kosovën. Ai fuqizoi strukturën institucionale dhe sqaroi rolet e institucioneve të ndryshme.

Ligjet e reja riparuan mungesat e kaluara në kornizën ligjore duke rregulluar kornizën jo-gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe duke siguruar pajtueshmëri me standardet evropiane për të drejta të njeriut si dhe konventat ndërkombëtare. Ato janë në veçanti të vlefshme pasi që përkufizojnë kompetencat dhe ndërveprimet mes organeve të ndryshme me kompetenca në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore dhe konfirmojnë rolin e Institucionit të Avokatit të popullit si organi kryesor kompetent në fushën e të drejtave themelore.

Korniza ligjore e Kosovës për barazi mes grave dhe burrave u përmirësua përmes miratimit të LBGJ-së në pajtim me standardet ndërkombëtare. Sidoqoftë, mbeten sfida të dukshme strukturore dhe zbatimi do të kërkojë përpjekje serioze. Gratë vazhdojnë të mbeten më pak të përfaqësuara në pozitat vendimarrëse, përfshirë nivelin lokal. Në nivel shtetëror, situata u përkeqësua, pasi që vetëm dy (2)<sup>16</sup> ministre nga 22 janë gra dhe vetëm dy (2) nga 14<sup>17</sup> kryesues të komisioneve parlamentare<sup>18</sup>. Megjithatë, edhe pse gratë vazhdojnë të jenë më pak të përfaqësuara në vendimmarrje, Raporti i KE-së për Kosovën i vitit 2016 nuk përmend një dukuri të tillë.

Diskriminimi në bazë gjinore ndalohet sipas nenit 1 të Ligjit Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi i cili, ndër të tjera, përfshin edhe ndalimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit në bazë gjinore.

<sup>12</sup> Neni 101 [Shërbimi Civil] 1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.

<sup>13</sup> 7.2 Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat tjera të jetës shoqërore.

<sup>14</sup> ERAC: STRATEGJIA E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË 2016—2022: NJË RRUGË QË DUHET NDJEKUR

<sup>15</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës

<sup>16</sup> Deri më tani (18 janar 2017), janë tri (3) ministre në Qeverinë e Kosovës (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe Ministria pa Portofol) (<http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,43>)

<sup>17</sup> Deri më tani (18 janar 2017), janë gjashtë (6) kryesues të 15 komisioneve parlamentare <http://assembly-kosova.org/?cid=1,110>

<sup>18</sup> Raporti i KE-së për Kosovën 2015

Ligji për Barazi Gjinore (Nr. 05/L -020) trajton këtë çështje në më tepër hollësi. Ky Ligj garanton, mbrohet dhe promovon barazinë gjinore si vlerë demokratike dhe kërkon pjesëmarrje dhe kontribut të të dy gjinive në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në sferat tjera të jetës. Kjo pjesëmarrje dhe përfaqësim i barabartë arrihet kur të sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) në organet drejtuese dhe vendimmarrëse në të gjitha organet legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe institucionet tjera publike. Neni 6 i LBGJ-së gjithashtu ofron masa të veçanta të përkohshme që duhet të ndërmerren nga institucionet për të përshpejtuar barazinë gjinore. Për më tepër, Ligji përcakton ABGJ-në si mekanizëm institucional për barazi gjinore,<sup>19</sup> me përgjegjësinë për të bashkërenduar përgatitjen e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, monitoruar zbatimin e tij dhe për të raportuar tek Qeveria për zbatimin e tij. Qeveria, pas shqyrtimit dhe miratimit të Programit, raporton tek Kuvendi dhe e bën raportin publik. Programi i fundit që ABGJ ka përgatitur përfshin periudhën 2007-2013. Gjatë intervistës joformale me Ushtruesen e detyrës të Kryeshefes ekzekutive të ABGJ-së, u tha që është duke u punuar për të përfunduar programin e ri, i cili do të përfundohet gjatë vitit 2017.

Vlen të theksohet se Ligji për zgjedhjet e përgjithshme nuk është në pajtim me LBGJ-në,<sup>20</sup> përkatësisht ai kërkon një kuotë prej 30% të të gjithë kandidatëve në listën e kandidatëve të një partie politike të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar, përderia LBGJ parashikon pjesëmarrje të barabartë (50%) në çdo nivel të vendimmarrjes në jetën politike dhe publike.

Të gjitha materialet e shqyrtuara për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në Kosovë ofrojnë dëshmi për gjendjen e pafavorshme të grave që kërkon vëmendje dhe përmirësim të mëtejshëm. Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Gratë, paqja dhe siguria" u lansua në vitin 2014, i cili synon rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje. Sipas Planit të Veprimit (ABGJ, 2014) kuotat në administratën publike ishin të mira gjatë viteve 2009-2011, megjithatë pozitat drejtuese akoma dominoheshin nga burrat.<sup>21</sup> Objektivi i parë i Planit të Veprimit ishte "Pjesëmarrje e rritur e grave në vendimmarrje dhe në proceset e ndërtimit dhe ruajtjes së paqes". Prandaj, për të arritur këtë objektiv, Plani i Veprimit, në treguesin e tij, parashikonte një përqindje të grave në pozita drejtuese dhe pozita të larta drejtuese prej 20% të arrihej deri në vitin 2015.

Sipas kompetencave të përcaktuara në Shtojcën 11 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ministria përgjegjëse për administratën publike i raporton Kuvendit të Kosovës të paktën një herë në vit për gjendjen e shërbimit civil. Ky raport, që përgatitet nga Departamenti i Shërbimit Civil në MAP, përfshin pjesën e përfaqësimit gjinor dhe pozitive drejtuese. Megjithatë, gjatë hulumtimit tonë kemi vënë re se raporti i fundit që MAP ka publikuar në faqen e tyre të internetit ishte në vitin 2013.<sup>22</sup>

<sup>19</sup> Neni 7 - Agjencia për Barazi Gjinore është Agjenci Ekzekutive (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM-së).

<sup>20</sup> Ligji për Barazi Gjinore <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

<sup>21</sup> Agjencia për Barazi Gjinore, Plani i Veprimit për të zbatuar Rezolutën 1325 "Gratë, paqja dhe siguria" 2013-2015 Vetëm 13.10% pozita drejtuese mbaheshin nga gratë në vitin 2011 dhe 25.7% gra në pozita të larta menaxheriale.

<sup>22</sup> Ministria e Administratës Publike, Raportet <http://MPA.rks-gov.net/institucion/Publications/Raportet-Vjetore.aspx>

## HULUMTIME DHE RAPORTE TË MËPARSHME

Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë është diskutuar shumë here më parë. Megjithatë, shumë pak ka ndryshuar apo është përmirësuar bazuar në rekomandimet e hulumtimeve të mëparshme. Sipas një raporti të ABGJ-së,<sup>23</sup> numri i vogël i grave në pozita vendimmarrëse sfidohet nga kolegët e tyre, të cilët shpërfillin autoritetin e tyre ose nuk i kryejnë detyrat e deleguara te ata. Raporti gjithashtu paraqet arsyet që të anketuarit kanë dhënë për faktorët që pamundësojnë gratë në marrjen e përgjegjësive dhe pozitive vendimmarrëse në punë. Sipas këtij raporti, ofrimi i mundësive dhe mungesa e përkrahjes nga strukturat udhëheqëse përbëjnë rreth 70% të faktorëve, të pasuar nga përgatitja profesionale, obligimet familjare dhe rrethana tjera.

Sipas një hulumtimi tjetër të ABGJ-së<sup>24</sup> duket se pjesëmarrja e grave në ministrinë e Kosovës është rritur përgjatë viteve (2008 - 33%, 2009 - 36%, 2014 - 42%), përderisa ajo në komuna ka rënë (2008 - 38%, 2009 - 39%, 2014 - 27%). Ky hulumtim përfshin një anketë me gra në pozita jovendimmarrëse, 78% e të cilave me shkollim universitar dhe pasuniversitar (Bacelor, Master, Doktoraturë). Megjithëse 73% prej tyre kanë aplikuar, ato vazhdojnë të mos kenë pozitë vendimmarrëse dhe 30% prej tyre e shohin gjininë e tyre si një arsye për mundësitë më të pakta të ofruara për ngritje në detyrë. Ndër arsyet kryesore pse grave nuk u ofrohen mundësi të barabarta është besimi që burrat janë udhëheqës më të mirë dhe se gratë nuk kanë përkrahje politike.<sup>25</sup> Rezultatet nga anketa e këtij raporti gjithashtu tregojnë që gratë në pozita jo vendimmarrëse kanë pohuar se më shumë se gjysma e tyre (54%) mendojnë që grave nuk iu ofrohen mundësitë e njëjta si burrave për ngritje në detyrë, përderisa 46% mendojnë se mundësitë janë të njëjta pavarësisht gjinisë.

Duke marrë parasysh historinë e freskët të Kosovës, është e rëndësishme për Kosovën të bashkohet në BE për progress dhe stabilitet shtetëror. Përmes këtij fokusi në bashkimin e mëtejshëm drejt BE-së, të drejtat e njeriud duhet të jenë pikë qendrore në programin qeveritar të Kosovës.<sup>26</sup> Arritja e barazisë gjinore është themelore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, funksionimin e demokracisë, respektimin e sundimit të ligjit, zhvillimin ekonomik dhe konkurrencën.<sup>27</sup>

Barazia gjinore është në themel të vlerave evropiane dhe e mishëruar në kornizën politike dhe ligjore të Bashkimit Evropian (BE). BE-ja dhe shtetet e saj anëtare janë në ballë të mbrojtjes, përbushjes dhe zotërimit të të drejtave të njeriut nga gratë dhe vajzat dhe fuqishëm i promovojnë ato në të gjitha marrëdhëniet me jashtë, gjithashtu përtej bashkëpunimit për zhvillim.<sup>28</sup>

Raporti i KE-së për vitin 2016 e pranon që korniza ligjore e Kosovës është përmirësuar dhe thekson që ABGJ-ja akoma nuk e ka vlerësuar zbatimin e programit për barazi gjinore (2008-2013), dhe se mbeten sfida strukturore dhe zbatimi do të kërkojë përpjekje serioze. Në raport përmendet edhe fakti që vendi i punës i Kryeshefes ekzekutive të ABGJ-së nuk është plotësuar, si një factor që ka vështirësuar zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë. Prandaj, theksohet nevoja për të fuqizuar më tej rolin e ABGJ-së në politikëbërje.

<sup>23</sup> Agjencia për Barazi Gjinore (2011), Raporti i hulumtimit "Gratë në procesin e punës dhe vendimmarrja në Kosovë"

<sup>24</sup> Agjencia për Barazi Gjinore (2014), Raporti i hulumtimit: Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale, dhe në partitë politike në Kosovë, Prishtinë

<sup>25</sup> Agjencia për Barazi Gjinore (2014), Raporti i hulumtimit: Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale, dhe në partitë politike në Kosovë

<sup>26</sup> ERAC: STRATEGJIA E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË 2016—2022: NJË RRUGË QË DUHET NDJEKUR, f. 9

<sup>27</sup> Strategjia për Barazi Gjinore (2014-2017) e Këshillit të Evropës

<sup>28</sup> Përfundimet e Këshillit Evropian në Planin e Veprimit Gjinor 2016-2020

Sa i përket mosdiskriminimit, Raporti i KE-së thekson se nuk është miratuar akoma legjislacioni dytësor për zbatim të ligjit për mbrojtje nga diskriminimi. Për më tepër, përmendet nevoja që autoritetet të trajtojnë diskriminimin ndaj grave, veçanërisht gjatë proceseve të punësimit në sektorin privat. Raporti përmend faktin që performanca e institucioneve në përpunimin dhe hetimin e rasteve të diskriminimit mbetet e dobët dhe thërret për marrjen e masave për të shtuar pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Pengesat që pushimi i lehonisë paraqet në punësimin e grave si dhe qasja e kufizuar në shërbimet e kujdesit për fëmijë dhe në rregullime fleksibile të punës që janë pengesa për punësimin e grave përshkruhen mirë përgjatë raportit, duke i kërkuar shtetit të mendojë për një reformë të sistemit të pushimit të lehonisë dhe prindëror.

Raportet e progresit të viteve të kaluara kanë theksuar problemet e lidhura me përfaqësimin e grave në pozita vendimmarrëse, duke e përshkruar atë si të përkeqësuar në nivel shtetëror krahasuar me vitet e mëparshme (KE, 2015), problemet lidhur me moszbatimin e LBGJ-së (KE, 2014; KE, 2012) dhe nevojën për ndryshimin e tij (KE, 2013).

Plani i ri i Veprimit Gjinator i BE-së (2016-2020) që është përgatitur pason PVGj 2010-2015, që ka vuajtur nga udhëheqje, llogaridhënie dhe kapacitet i dobët institucional.<sup>29</sup> Korniza e BE-së, Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: transformimi i jetëve të vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së 2016-2020, prezanton një qasje ambicioze për barazi gjinore dhe promovim, mbrojtje dhe plotësim të të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave. Plani i Ri i Veprimit Gjinator synon të përqendrojë përpjekjet e të gjitha palëve në BE (EEAS, Delegacionet, shërbimet e Komisionit dhe shtetet anëtare) në katër fusha kryesore: një horizontale për ndërrimin e kulturës institucionale, dhe tri fusha tematike: integritet psikologjik dhe fizik i grave dhe vajzave, të drejtat e tyre ekonomike dhe shoqërore, dhe zëri dhe pjesëmarrja.<sup>30</sup>

Deklaratat dhe konventat tjera dhe analizat ndërkombëtare i japin rëndësi të madhe pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe kanë krijuar një kornizë të standardeve ndërkombëtare të barazisë. Këto përfshijnë Deklaratën universale për të drejtat e njeriut,<sup>31</sup> Paktin Ndërkombëtar për të drejtat Civile dhe Politike,<sup>32</sup> Konventën për të drejtat politike të grave,<sup>33</sup> Deklaratën e Vienës,<sup>34</sup> paragrafin 13 të Deklaratës dhe Planit të Veprimit të Pekinit,<sup>35</sup> Rekomandimet e përgjithshme 5 dhe 8 sipas Konventës,<sup>36</sup> Komentin epërgjithshëm 25 të miratuar nga Komisioni për të drejtat e njeriut,<sup>37</sup> rekomandimin e miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në procesin vendimmarrës<sup>38</sup> dhe "Si të krijojmë një balancë gjinore në vendimmarrjen politike" i Komisionit Evropian".<sup>39</sup>

<sup>29</sup> Plani i ri i Veprimit Gjinator i BE-së 2016-2020

<sup>30</sup> Plani i ri i Veprimit Gjinator i BE-së 2016-2020

<sup>31</sup> Rezoluta 217 A (III) e Asamblesë së Përgjithshme

<sup>32</sup> Rezoluta 2200 A (XXI), shtojca. e Asamblesë së Përgjithshme

<sup>33</sup> Rezoluta 640 (VII) e Asamblesë së Përgjithshme

<sup>34</sup> Raporti i Konferencës Botërore për të drejtat e njeriut, Vienë, 14-25 qershor 1993 (A/CONF.157/24 (Pjesa I)), kap. III.

<sup>35</sup> Raporti i Konferencës së katërt botërore për Gratë, Pekin, 4-15 shtator 1995 (A/CONF.177/20 dhe Add.1), kap. I, rezoluta 1, shtojca I.

<sup>36</sup> Shënimet zyrtare të Asamblesë së Përgjithshme, Sesioni i dyzetë e tretë, Shtojca Nr. 38 (A/43/38), kap. V.

<sup>37</sup> Përpilim i Komenteve të përgjithshme dhe Rekomandimeve të përgjithshme të miratuara nga Organet e traktatit për të drejtat e njeriut CCPR/21/21/Rev.1/Add.7, 27 gusht 1996.

<sup>38</sup> 96/694/EC, Bruksel, 2 dhjetor 1996

<sup>39</sup> Dokumenti i Komisionit Evropian V/1206/96-EN (mars 1996).



## GJENDJA AKTUALE

Hulumtimi kishte për qëllim analizimin e gjendjes aktuale të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal në Kosovë. Institucionet e përfshira në këtë hulumtim janë: Qeveria e Kosovës, Kuvendi, Presidenca dhe komunat.


### Niveli qendror

Institucionet e nivelit qendror të përfshira në këtë hulumtim janë Qeveria, Kuvendi, dhe Presidenca. Të dhënat që ekipi hulumtues i QKSGJ-së ka arritur të mbledh janë ato të shërbyesve civil të Qeverisë (Ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit), shërbyesve civil të Kuvendit, dhe shërbyesve civil dhe këshilltarëve politik të Presidentit.

### Qeveria

Përkundër kërkesave të vazhdueshme për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, si nga faktori vendor edhe ai ndërkombëtar, që kërkon përfaqësim të barabartë për të dy gjinitë, nga të dhënat e mbledhura gjatë hulumtimit del se Qeveria jo vetëm që nuk e ka respektuar këtë kërkesë, por ka zvogëluar numrin e grave në administratën publike. Përqindja e grave në numrin e përgjithshëm të të punësuarëve në Qeverinë vitin 2015 ka qenë 41.8 % ndërkaq në vitin 2016 ka qenë 40.6%.

Përfaqësimi gjinor në Qeveri



Grafiku 1. Përfaqësimi gjinor në Qeveri

Edhe në nivel ministror përfaqësimi gjinor vazhdon të mbetet një çështje shqetësuese. Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës në vazhdimësi ka përqindje të vogël të përfaqësimit të gruas (2013 - 24.8%; 2014 - 24.3%; 2015 - 24.8%; 2016 - 26.5%). Ministria e Infrastrukturës vazhdon t'i nënpërfaqësojë gratë (25.1% në vitin 2016). Gjinitë janë më barabarsisht të përfaqësuara në Ministrinë e Shëndetësisë (2016 - 54.9%). Ministria e Integritit Evropian (50.8%), Zyra e Kryeministrit (50.9%) dhe Ministria e Financave (50.3%) gjithashtu kanë shfaqur përfaqësim të barabartë të gjinive gjatë vitit 2016.

Tabelat në vijim pasqyrojnë përfaqësimin gjinor sipas ministrive, të ndarë në dy grupe për secilin vit të përfshirë në hulumtim:

1. Ministrinë që janë zbatojnë LBGJ-në; dhe
2. Ministrinë që nuk zbatojnë LBGJ-në.

Në vitin 2013, kërkesa ligjore nga LBGJ ishte të ketë 40% përfaqësim të grave, që siç paraqitet në tabelën më poshtë u respektua nga 10 ministri.

	Grupi 1	Grupi 2
2013	Ministria e Shëndetësisë (54.4%)	Ministria e Punëve të Brendshme (39.7%)
	Ministria e Integritimit Evropian (52.2%)	Ministria për Komunitete dhe Kthim (39.2%)
	Ministria e Diasporës (48.6%)	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (39.1%)
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (47.1%)	Ministria e Drejtësisë (39%)
	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (46.8%)	Ministria e Financave (36.3%)
	Zyra e Kryeministrit (43.9%)	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (32.4%)
	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (43.6%)	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (29.1%)
	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (41.4%)	Ministria e Punëve të Jashtme (27.4%)
	Ministria e Administratës Publike (41.4%)	Ministria e Infrastrukturës (25.2%)
	Ministria e Zhvillimit Ekonomik (40.8%)	Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës (24.8%)

Tabela 1. Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin 2013

Situata në vitin 2014 sa i përket përfaqësimit të grave në Qeveri vazhdoi të ishte e njëjtë si në vitin paraprak me një ndryshim të vogël në përqindje në ministri të caktuara. Për shembull, Ministria e Drejtësisë rriti pjesëmarrjen në 40.4%, përderisa Ministria e Zhvillimit Ekonomik zvogëloi përqindjen e saj në 39.7%.

	Grupi 1	Grupi 2
2014	Ministria e Shëndetësisë (55%)	Ministria e Zhvillimit Ekonomik (39.7%)
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (46.6%)	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (39.2%)
	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (46.2%)	Ministria e Punëve të Brendshme (37.9%)
	Ministria e Integritimit Evropian (45.7%)	Ministria për Komunitete dhe Kthim (37.5%)
	Zyra e Kryeministrit (44.2%)	Ministria e Financave (36.4%)
	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (42.4%)	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (34.4%)
	Ministria e Administratës Publike (41.5%)	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (29.7%)
	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (40.8%)	Ministria e Punëve të Jashtme (29.3%)
	Ministria e Drejtësisë (40.4%)	Ministria e Infrastrukturës (25.2%)
	Ministria e Diasporës (40.4%)	Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës (24.3%)

Tabela 2. Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin 2014

2015 shënon hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Barazi Gjinore, që kërkon si burrat edhe gratë të përfaqësohen në mënyrë të barabartë. Vetëm tri ministri përbushin këtë kërkesë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Integritimit Evropian dhe Ministria e Financave. Në anën tjetër, ministrinë me përfaqësimin më të ulët të grave në vitin 2015 ishin: Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës. Këto ministri kanë qenë në fund të grupit gjatë tërë periudhës së përfshirë nga hulumtimi ynë, domethënë 2013-2016.

	Grupi 1	Grupi 2
2015	Ministria e Shëndetësisë (54.9%) Ministria e Integritimeve Evropiane (52.2%) Ministria e Financave (50.3%)	Zyra e Kryeministrit (49.5%) Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (49%) Ministria e Diasporës (48.6%) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (47.1%) Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (46.8%) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (44.9%) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (42.5%) Ministria e Drejtësisë (42%) Ministria e Administratës Publike (41%) Ministria e Zhvillimit Ekonomik (40.8%) Ministria e Punëve të Brendshme (39.7%) Ministria për Komunitete dhe Kthim (39.2%) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (38.4%) Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (32.4%) Ministria e Punëve të Jashtme (27.4%) Ministria e Infrastrukturës (25.2%) Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës (24.8%)

Tabela 3. Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin for 2015


Në vitin 2016, Zyra e Kryeministrit rriti përqindjen e saj të përfaqësimit të grave në 50.9%, duke qenë në pajtim me kërkesat e LBGJ-së. Ndryshimet në ministritë tjera mbeten të parëndësishme.

	Grupi 1	Grupi 2
2016 <sup>1</sup>	Ministria e Shëndetësisë (54.9%) Zyra e Kryeministrit (50.9%) Ministria e Integritimeve Evropiane (50.8%) Ministria e Financave (50.3%)	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (46.8%) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (46.2%) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (44.4%) Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (44.4%) Ministria e Drejtësisë (42%) Ministria e Zhvillimit Ekonomik (40.6%) Ministria e Punëve të Brendshme (39.7%) Ministria e Diasporës (39.6%) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (37.8%) Ministria e Administratës Publike (37.7%) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (37.3%) Ministria për Komunitete dhe Kthim (35.6%) Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (32.3%) Ministria e Punëve të Jashtme (30%) Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës (26.5%) Ministria e Infrastrukturës (25.1%)

Tabela 4. Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin 2016

<sup>40</sup> Të dhënat e vitit 2016 përfshijnë tremujorin e parë


## Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin 2016



Grafiku 2. Përfaqësimi i grave sipas ministrive për vitin 2016

Sa i përket pozitive të larta drejtuese në qeveri <sup>41</sup>, ato vazhdojnë të dominohen nga burrat. Gratë drejtuan vetëm 9.8% të numrit të përgjithshëm të këtyre pozitive në vitin 2013, përderisa në vitin 2014 kjo përqindje kishte rënë për 3.1%, pra vetëm 6.7% të pozitive të larta drejtuese drejtoreshin nga gratë. Në vitin 2015, përqindja e grave në pozita të larta drejtuese në Qeveri ishte zvogëluar edhe më tej, duke e sjellë numrin në vetëm 5.2%, domethënë vetëm 3 pozita nga një numër i përgjithshëm prej 58.

## Pozitat e larta drejtuese në qeveri



Grafiku 3. Pozitat e larta drejtuese në qeveri <sup>42</sup>


Burrat udhëhoqën gjithashtu pozitat drejtuese <sup>43</sup> në këto tri vite dhe vetëm pak më shumë se 26% të pozitive drejtoreshin nga gratë.

<sup>41</sup> Sekretar i përgjithshëm, Kryeshef ekzekutiv dhe Drejtor ekzekutiv

<sup>42</sup> Nuk janë ofruar të dhëna për vitin 2016

<sup>43</sup> Drejtor i departamentit/Drejtoratit, Zëvendës Drejtor, Shef i Zyrës, Shef i Sektorit, Shef i njësisë, Menaxher dhe Auditor

### Pozitat drejtuese në qeveri



	2013	2014	2015
F	26,1%	26,5%	26,1%
M	73,9%	73,5%	73,9%

Grafiku 4. Pozitat drejtuese në qeveri <sup>44</sup>

Tabela në vijim pasqyron numrin e grave në pozitat e larta drejtuese sipas ministrive. Siç mund të shihet në tabelën e parë, në vitin 2015 kanë qenë vetë 3 (5.2%) gra drejtuese të larta në Qeveri, që paraqet një rënie nga vitet e mëparshme të përfshira nga hulumtimi ynë. Në vitin 2014, 6.7% (3) të pozitave të larta drejtuese u mbajtën nga gratë, përderisa kjo përqindje ishte edhe më e lartë në vitin 2013, përkatësisht 9.8% (4).

	2013	2014	2015 <sup>45</sup>
Pozitat e larta drejtuese	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (1/6)	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (2/7)	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (1/7)
	Ministria e Drejtësisë (1/1)	Ministria e Punëve të Jashtme (1/3)	Ministria e Administratës Publike (1/3)
	Ministria për Komunitete dhe Kthim (1/1)		Ministria e Punëve të Jashtme (1/4)
	Ministria e Diasporës (1/1)		
	4 out of 41 (9.8%)	3 out of 45 (6.7%)	3 out of 58 (5.2%)

Tabela 5. Pozitat e larta drejtuese sipas ministrive <sup>46</sup>

Tabela 6 paraqet numrin e grave në pozita drejtuese në secilën ministri. Në vitin 2015, kanë qenë 26.1% gra drejtuese në Qeveri. Përqindjet në tri vitet e përfshira nga hulumtimi ynë kanë mbetur të njëjta, me një ndryshim të parëndësishëm prej 0.4% në vitin 2014.

<sup>44</sup> Nuk janë ofruar të dhëna për vitin 2016

<sup>45</sup> Ministrinë që nuk kishin asnjë grua në pozita të larta drejtuese në vitin 2015 ishin: MD, MAPL, MPMS, MASHT, MKRS, MZHE, MPB, MKK, MMPH, MBPZHR, MI, MFSK, MSH, MIE, dhe ZK.

<sup>46</sup> Nuk janë ofruar të dhëna për vitin 2016

	2013	2014	2015
Pozitat drejtuese	Ministria e Punëve të Brendshme (31/153)	Ministria e Punëve të Brendshme (29/155)	Zyra e Kryeministrit (11/32)
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (29/112)	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (27/96)	Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës (10/37)
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (16/59)	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (20/59)	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (10/32)
	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (13/54)	Ministria e Administratës Publike (18/52)	Ministria e Shëndetësisë (16/48)
	Ministria e Administratës Publike (19/51)	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (15/48)	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (15/55)
	Ministria e Infrastrukturës (7/47)	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (10/41)	Ministria e Infrastrukturës (7/36)
	Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës (12/41)	Ministria e Drejtësisë (10/41)	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (28/95)
	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (13/39)	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (8/41)	Ministria e Administratës Publike (14/42)
	Ministria e Ekonomisë dhe Financave (12/35)	Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës (12/40)	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (13/39)
	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (6/34)	Ministria e Ekonomisë dhe Financave (12/35)	Ministria e Ekonomisë dhe Financave (57/214)
	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (10/34)	Ministria e Shëndetësisë (11/34)	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (10/61)
	Ministria e Zhvillimit Ekonomik (8/31)	Ministria e Zhvillimit Ekonomik (11/34)	Ministria e Zhvillimit Ekonomik (5/25)
	Zyra e Kryeministrit (4/28)	Ministria e Infrastrukturës (4/31)	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (8/25)
	Ministria e Shëndetësisë (10/27)	Zyra e Kryeministrit (6/30)	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (19/61)
	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (9/25)	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (9/28)	Ministria e Drejtësisë (33/185)
	Ministria e Punëve të Jashtme (6/20)	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (8/24)	Ministria e Punëve të Brendshme (33/185)
	Ministria për Komunitete dhe Kthim (3/15)	Ministria e Integrimi Evropiane (6/22)	Ministria e Punëve të Jashtme (7/18)
	Ministria e Integrimi Evropiane (3/12)	Ministria e Punëve të Jashtme (5/21)	Ministria për Komunitete dhe Kthim (3/13)
	Ministria e Diasporës (4/9)	Ministria për Komunitete dhe Kthim (3/14)	Ministria e Integrimi Evropiane (8/25)
	Ministria e Drejtësisë (1/1)	Ministria e Diasporës (4/13)	Ministria e Diasporës (3/15)
	216 nga 827 (26.1%)	228 nga 859 (26.5%)	301 nga 1155 (26.1%)


Tabela 6. Pozitat drejtuese sipas ministrive<sup>47</sup>

## Shërbyesit civil të Kuvendit

Të dhënat e siguruar nga MAP-i për shërbyesit civil në Kuvendin e Kosovës tregojnë që barazia gjinore nuk respektohet as në vetë institucionin që miraton ligjet në Kosovë. Përkundër një rritjeje të vogël të përqindjes së përfaqësimit të grave në administratën e Kuvendit (nga 43.6% në vitin 2015 në 44.2% në vitin 2016), gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar edhe në këtë institucion qendror të Kosovës.

<sup>47</sup> Nuk janë ofruar të dhëna për vitin 2016

### Përfaqësimi gjinor në Kuvend




Grafiku 5. Përfaqësimi gjinor në Kuvend

Gratë vazhdojnë të mbeten të nënpërfaqësuar në pozitat drejtuese në Kuvend. Sa i përket pozitave të larta drejtuese, nuk ka pasur asnjë grua të përfaqësuar për këto tri vite sa ka përfshirë ky hulumtim. Situata është pak më e mirë në pozitat drejtuese, megjithatë është e pabarabartë dhe jo në pajtueshmëri me LBGJ-në.

Siç shihet nga grafiku më poshtë, në vitin 2013, vetëm 13 nga 37 pozita drejtoreshin nga gratë (përfshirë një pozitë të lartë drejtuese) ose 35.1%. Në vitin 2014 ishte shënuar rritje prej 6 pozitash të drejtuara nga gratë, megjithatë, kjo kishte shënuar një rritje prej vetëm 2.2%, përkatësisht 37.3%, për shkak se edhe pozitat e udhëhequra nga burrat ishin rritur në 32 nga 24 sa kishin qenë në vitin 2013. Në vitin 2015, Kuvendi ka punësuar një burrë në një pozitë (të lartë) drejtuese, duke zvogëluar në këtë mënyrë përqindjen e grave në 36.5%.

### Pozitat (e larta) drejtuese në Kuvend




Grafiku 6. Pozitat (e larta) drejtuese në Kuvend<sup>48</sup>

<sup>48</sup> Nuk janë ofruar të dhëna për vitin 2016


## Presidenca

Sipas të dhënave të siguruara nga Presidenca për këshilltarët politik të Presidentit, duket se barazia gjinore është respektuar gjatë viteve 2013-2015 (8 këshilltarë gjithsej - 4 burra dhe 4 gra). Në anën tjetër, në vitin 2016 ka qenë një grua më pak si këshilltare politike e Presidentit.<sup>49</sup>



Grafiku 7. Këshilltarët politik të Presidentit

Përkundër respektimit të barazisë gjinore në rastin e këshilltarëve politik (me përjashtim të vitit 2016), nga të dhënat që kemi marrë për përfaqësimin gjinor të nëpunësve civil në Presidencë del se ajo në vazhdimësi nuk është duke respektuar barazinë gjinore. Përfaqësimi i burrave në Presidencë është 62.8% kurse ai i grave 37.2% dhe kjo gjendje është gjatë gjithë periudhës që përfshin ky hulumtim.




Grafiku 8. Përfaqësimi gjinor në Presidencë

<sup>49</sup> Sipas komunikimit personal, Presidenti nuk e ka plotësuar akoma Kabinetin e tij




Edhe në pozita drejtuese në Presidencë favorizohen burrat. Nga 32 pozita drejtuese gjithsej (në nivel të lartë drejtues dhe në nivel drejtues), 18 pozita udhëhiqeshin nga burrat dhe 14 nga gratë. Kjo gjendje ka qenë e njëjtë për të tri vitet e përfshira në hulumtim, përderisa për vitin 2016 nuk kemi të dhëna.



Grafiku 9. Pozitat (e larta) drejtuese në Presidencë

### Niveli lokal


Sipas të dhënave të ofruara nga Zyrtarja për barazi gjinore në MAPL, duket qartë që barazia gjinore në komunat e Kosovës nuk respektohet. Në vitin 2015, vetëm 28% të të punësuarëve në shërbimin civil ishin gra, përderisa kjo situatë ka qenë edhe më e rëndë në vitet 2013-2014<sup>50</sup> me vetëm një të katërtën (25%) e të punësuarëve që i takojnë kësaj kategorie.



Grafiku 10. Përfaqësimi gjinor në komuna

<sup>50</sup> Të dhënat e ofruara nga MAPL janë të organizuara në këtë mënyrë

Është shqetësues fakti që asnjë komunë nuk e ka respektuar LBGJ-në gjatë viteve 2013-2014, përderisa situata nuk është përmirësuar as në vitin 2015. Vetëm Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut ka respektuar barazinë gjinore, duke pasur të punësuar 37 gra nga 71 zyrtarë gjithsej, pra 52.1%, përderisa komuna e Dragashit dhe Hanit të Elezit radhiten në fund të tabelës me një përqindje më të vogël se 10%, përkatësisht 9.2% dhe 7.5%.




**Grafiku 11. Përfaqësimi i grave në secilën komunë**

Duhet të theksohet se të dhënat për vitin 2016 nuk janë ofruar, përderisa për komunën e Istogut dhe Shtërpçës nuk ka pasur të dhëna as për vitin 2015. Për më tepër, mungojnë të dhënat për komunat e veriut të Kosovës, përkatësisht Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.


Pozitat drejtuese në Komuna, do të thotë drejtorët e drejtorateve komunale, vazhdojnë të udhëhiqen në masë të madhe nga burrat. Vetëm 4.4% e pozitave në vitin 2013-2014 drejtoheshin nga gratë, përderisa kjo përqindje është rritur në 10.1% për vitin 2015.

## Pozitat drejtuese në komuna



Grafiku 12. Pozitat drejtuese në Komuna - drejtorët e drejtorateve komunale<sup>51</sup>

Grafikonet në vijim paraqesin ndarjen e pozitave drejtuese në komunitat e Kosovës sipas viteve. Vetëm 12 komuna kishin një apo dy drejtorë të drejtorateve gjatë periudhës 2013-2014, duke përgjithësuar këtë numër në 14 ose vetëm 4.4% nga 301 pozita drejtorësh në tërë Kosovën. Komuna e Gjakovës dhe Fushë Kosovës kishin nga dy drejtorë gjatë kësaj periudhe.




Grafiku 13. Pozitat drejtuese në komunitat e Kosovës në 2013-2014

Në vitin 2015, 19 komuna kishin drejtorë. Komunitat me numrin më të madh të drejtorëve ishin: Komuna e Fushë Kosovës, Kamenicës dhe Vushtrrisë me nga 3 pozita.

<sup>51</sup> Nuk janë ofruar të dhëna për vitin 2016

Pozitat drejtuese në komunat e Kosovës në vitin 2015



Grafiku 14. Pozitat drejtuese në komunat e Kosovës në vitin 2015 <sup>52</sup>

<sup>52</sup> Komunat pa gra në pozitadrejtuese ishin: Klina, Kaçaniku, Podujeva, Rahoveci, Deçani, Hani i Elezit, Parteshi, ZAMV, Mamusha, Malisheva, Skenderaj, Dragashi, Lipjani, Istogu, Obiliqi, Juniku, Ferizaj, Mitrovica, Malisheva, Suhareka, Shtimja, Gjilani, Peja, Vushtrria

## PËRFUNDIME

Bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë hulumtimit, i cili ka përfshirë periudhën tri vjecare (2013-2016), duket se LBGJ vazhdon të mos zbatohet, domethënë dispozita që kërkon përfaqësimin prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, dhe si e tillë mbetet problem i vazhdueshëm që kërkon një qasje më serioze institucionale.

Si Qeveria e Kosovës ashtu edhe Komunitetët vazhdojnë të mos respektojnë LBGJ-në. Nga të dhënat e mbledhura gjatë këtij hulumtimi, del se vetëm tri ministri dhe Zyra e Kryeministrit e respektojnë këtë Ligj sa i përket përfaqësimit gjinor, përderisa në komuna situata është edhe më e rëndë. Komunitetët e Kosovës në vitin 2015 kishin vetëm 28% të të punësuarëve gra, me vetëm një komunë, përkatësisht Zyrën Administrative të Mitrovicës së Veriut, që respektonte barazinë gjinore, përderisa kishte komuna që kishin nën 10% gra në administratën e tyre.

Edhe dy institucionet tjera qendrore, Kuvendi dhe Presidenca, nuk e kanë respektuar LBGJ-në gjatë këtyre viteve sa ka përfshirë hulumtimi. Kuvendi, në vitin 2016, ka pasur vetëm 44.2% gra në administratën e tij, përderisa Presidenca vetëm 37.2%.

Situata e përfaqësimit të grave në pozita vendimmarrëse vazhdon të jetë e pafavorshme. Në vitin 2015, vetëm 5.2% ose 3 nga 58 pozitat e larta drejtuese në Qeveri drejtoheshin nga gratë, kurse në pozita drejtuese ishin 26.1% ose 301 gra nga gjithsej 1155 pozita. Vlen të theksohet se vetëm në tri ministri gratë mbanin pozita të larta drejtuese. Gjendja në dy institucionet tjera qendrore nuk ishte më e mirë në vitin 2015. Nga 52 pozita drejtuese në Kuvend vetëm 19 drejtoheshin nga gratë, përderisa Presidenca kishte gra në 14 nga 32 pozitat e saj drejtuese.

Në anën tjetër, në vitin 2015, komunitetët e Kosovës kishin vetëm 32 gra në pozita drejtuese nga 318 pozita gjithsej, ose 10.1%. 14 nga komunitetët e Kosovës nuk kishin asnjë grua në pozita drejtuese. Kjo situatë është pak më e mirë krahasuar me atë në 2013-2014 kur 22 komuna nuk kishin asnjë grua në pozita të tilla.

## REKOMANDIME

---

Bazuar në të dhënat e mbledhura për gjendjen aktuale të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në Kosovë, Qendra Kosovare për Studime Gjinore jep rekomandimet në vijim:

- Rekomandohen institucionet shtetërore (veçanërisht ato me zbatueshmëri më të ulët si: Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Jashtme) të zbatojnë masat e veçanta nën nenin 6 të Ligjit për Barazi Gjinore për të përshpejtuar realizimin e barazisë gjinore në ato fusha ku ekzistojnë pabarazitë. Këto masa të veçanta duhet të përdoren në mënyrë sistematike kur ka vende të lira pune në institucione;
- Rekomandohet Agjencia për Barazi Gjinore të përgatisë Programin e Kosovës për Barazi Gjinore dhe të marrë parasysh prioritetet që dalin nga Plani i ri i Veprimeve Gjinore të Bashkimit Evropian 2016-2020;
- Rekomandohet Ministria e Administratës Publike t'i publikojë statistikën dhe raportet e ndara sipas gjinisë për gjendjen në shërbimin civil në faqen e saj të internetit në mënyrë që të jenë të qasshme për palët e interesuara; dhe
- Rekomandohet Ministria e Administratës Publike t'i mbledh të dhënat e ndara sipas gjinisë për të emëruarit për pozitat e këshilltarëve politik të krerëve të shtetit të financuar nga buxheti i shtetit të Kosovës.

## HAPAT E RADHËS

---

Qendra Kosovare për Studime Gjinore do t'i përdorë të dhënat nga ky raport për të avokuar për përmirësimin e gjendjes aktuale sa i përket përfaqësimit të grave në vendimmarrje përmes projekteve të saj që do të zbatohen në vitin në vijim. Mes të tjerash, QKSGJ do të përfundojë një rast gjyqësor kundër një institucioni publik i cili shkel më së rëndi Ligjin për Barazi Gjinore. Rasti gjyqësor do të ndërmerret gjatë zbatimit të projektit, duke e përgatitur kështu rrugën dhe duke krijuar njohuri për organizatat lokale për të vazhduar më tej ushtrimin e rolit të tyre për zbatim të përmirësuar të politikave.

Gjithashtu, QKSGJ do të bindë Ministrinë e Administratës Publike të publikojë të dhënat e shërbyesve civil të ndara sipas gjinisë.

## REFERENCAT:

Agjencia për Barazi Gjinore (2011). Gratë në procesin e punës dhe vendimarrjes në Kosovë. [http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Raportit%20i%20hulumtimit%20"Grat%C3%AB%20n%C3%AB%20procesin%20e%20punes%20dhe%20Vendimarrjes%20"shqip%20A5%20-%2088%20faqe.pdf](http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Raportit%20i%20hulumtimit%20)

Agjencia për Barazi Gjinore (2014). Plani i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. <http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ%20Plani%20i%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Implementim%20t%C3%AB%20Rezolut%C3%ABs%201325%20tre%20gjuh%C3%AB.pdf>

Agjencia për Barazi Gjinore (2014). Raporti i hulumtimit Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale, dhe në partitë politike në Kosovë, Prishtinë, Kosovë. <http://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/country/kosovo/age%20raport%20oct%202014.pdf?vs=428141211>

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (1948). 217 A (III). Deklarata universale për të drejtat e njeriut. <http://www.un-documents.net/a3r217a.htm>

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (1952). 640 (VII). Konventa për të drejtat politike të grave. <https://documents-dds-ny.un.org/doc/RESOLUTION/GEN/NR0/079/83/IMG/NR007983.pdf?OpenElement>

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (1966). 2200 (XXI). Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe police dhe Protokoli Zgjedhor i Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike. <http://www.un-documents.net/a21r2200.htm>

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (2011). Rezoluta 66/130 Gratë dhe pjesëmarrja politike. [http://www.un.org/en/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=%20A/RES/66/130](http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=%20A/RES/66/130)

ECOSOC (1990). Rezoluta E/RES/1990/15. [http://www.apav.pt/apav\\_v3/images/pdf/ResUN\\_ECOSOC\\_1990\\_22.pdf](http://www.apav.pt/apav_v3/images/pdf/ResUN_ECOSOC_1990_22.pdf)

Instituti Kombëtar Demokratik (IKD) (2015). Kosovë: Tejkalimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë. <https://www.ndi.org/sites/default/files/Gender-Assesment-report-ALB.pdf>

Këshilli Evropian (2015). Përfundime për Planin e Veprimit Gjinor 2016-2020. <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/26-fac-conclusions-gender-development/>

Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave (2003) Rekomandim. [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805e0848](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805e0848)

Këshilli i Evropës (2014) Strategjia për Barazi Gjinore (2014-2017). <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680590174>

Këshilli i Komunave dhe Rajoneve Evropiane (2006). Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Shoqërore. [http://www.ccre.org/docs/charte\\_egalite\\_en.pdf](http://www.ccre.org/docs/charte_egalite_en.pdf)



Këshilli i Sigurimit i OKB (2000). Rezoluta 1325 "Gratë, paqja dhe siguria". [http://www.mod.gov.al/images/PDF/gruaja\\_rezolute.pdf](http://www.mod.gov.al/images/PDF/gruaja_rezolute.pdf)

Koalicioni të drejtat e barabarta për të gjithë (ERAC) (2016). Strategjia e të drejtave të njeriut në Kosovë 2016—2022: Një rrugë që duhet ndjekur. [http://equalrightsforallcoalition.com/wp-content/uploads/2016/11/HR\\_Strategy\\_ALB.pdf](http://equalrightsforallcoalition.com/wp-content/uploads/2016/11/HR_Strategy_ALB.pdf)

Kofi Anan (2006). Roli i grave në vendimmarje qendror për progresin e njerëzimit, Sekretari i Përgjithsëm thotë për nder të Ditës së Grave. <http://www.unis.unvienna.org/unis/en/pressrels/2006/obv542.html>

Komisioni Evropian (2012). Raporti i Progresit për Kosovën [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_analytical\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf)

Komisioni Evropian (2014). Raporti i Progresit për Kosovën [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf)

Komisioni Evropian (2015). Raporti i Progresit për Kosovën [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)

Konferenca e katërt botërore për gratë (1995). Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit. [http://www.crca.al/sites/default/files/publications/3.2.1.8.Deklarata\\_dhe\\_Platforma\\_pr\\_Veprim\\_e\\_Pekinit.pdf](http://www.crca.al/sites/default/files/publications/3.2.1.8.Deklarata_dhe_Platforma_pr_Veprim_e_Pekinit.pdf)

Kuvendi i Kosovës (2008). Kushtetuta e Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Kuvendi i Kosovës (2015). Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

Kuvendi i Kosovës (2015a). Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

Kuvendi i Kosovës (2017). Lista e Komisioneve të Kuvendit të Kosovës. <http://assembly-kosova.org/?cid=1,110>

Ministria e Administratës Publike (2016). Raportet. <http://map.rks-gov.net/institucion/Publications/Raportet-Vjetore.aspx>

OKB (1995). Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit. <http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/pdf/BDPfA%20E.pdf>

OKB (1995a). Raporti për Konferencën e katërt botërore për gratë. <http://www.un.org/esa/gopher-data/conf/fwcw/off/a--20.en>

Shërbimi për Informim i OKB-së (2006). Roli i grave në vendimmarje qendror për progresin e njerëzimit, Sekretari i Përgjithsëm thotë për nder të Ditës së Grave. <http://www.unis.unvienna.org/unis/en/pressrels/2006/obv542.html>

Universiteti i Minesotas, Biblioteka e të drejtave të njeriut (1993). Deklarata e Vienës, Konferenca botërore për të drejtat e njeriut, Vienë, 14-25 qershor 1993, U.N. Doc. A/CONF.157/24 (Pjesa I) at 20 (1993). <http://hrlibrary.umn.edu/instree/l1viedec.html>

UN Women (2015). Gratë në Pushtet & Vendimmarrje. <http://beijing20.unwomen.org/en/infographic/decision-making>

Zyra e Kryeministrit (2011). Rregullorja Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja\\_02-2011-e\\_miratuar\\_nga\\_Qeveria-finale.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja_02-2011-e_miratuar_nga_Qeveria-finale.pdf)

Zyra e Kryeministrit (2017). Ministrat. <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,43>





Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë